

Bashkia, aktivitet për Ditën e Fqinjësisë

Që prej një viti, edhe në kryeqytet ka startuar festimë tradita e kremtimit të Festës së Fqinjëve, në kuadër të Ditës Europiane të Fqinjësisë së Mirë. Bashkia e Tiranës ka organizuar aktivitete të ndryshme nëpërmjet projektit me titull: "Të zhvillojmë së bashku kuptimin e vërtetë të komunitetit". Aktiviteti është zgjedhur të bëhet në zonën pranë Televizionit Shqiptar, për vetë faktin se prej më se një viti, këtu po zbatohet një projekt për selektimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane, si dhe është një zonë e rikonstruktuar rishtazi. Në këtë aktivitet janë mbledhur banorë të zonës, të cilët kanë treguar për problemet dhe shqetësimet që kanë, duke i ndarë me personat e tjerë të pranishëm. Në këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrës dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama.



Kryeqyteti kremton ditën evropiane që bashkon njerëzit me njeri-tjetrin

Tirana, në "festën e fqinjësisë"

Festa e fqinjësisë". Kjo është tradita më e re që ka filluar të krijohet edhe në kryeqytetin shqiptar, ceremoni kjo që zhvillohet suksesshëm në shumë vende të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Dje, Bashkia e Tiranës organizoi për të dytin vit radhazi këtë festë në kuadër të "Ditës Evropiane të Fqinjësisë së Mirë". Përmes projektit "të zhvillojmë së bashku kupimin e vërtetë të komunitetit", në kryeqytet u organizuan aktivitete të ndryshme në bllokun e televizionit pranë "Top Channel". Kjo ditë synon të promovojë fqinjësinë dhe bashkëjetesën në komunitet sipas standardeve evropiane, duke i ndërgjegjësuar banorët për një mjedis të qëndrueshëm e të shëndetshëm si pjesë e strategjisë lokale, si dhe duke i bashkuar ata rreth një feste të vogël.

Nuk ka munguar as festa me barbeque dhe pije ku të ftuar kanë qenë banorët e zonës së bllokut të televizionit dhe qytetarë të tjerë. Kjo zonë përbëhet nga një komunitet i përzier nivelesh shoqërore si biznese, ambasada, shkolla, institucione social-kulturale, vila dhe pallate. Banorë të këtij komuniteti, u mbledhën së bashku me qëllim jo vetëm argëtimin, por edhe ndarjen së bashku të problemeve të tyre. "Ne konsistojmë në këhimin e saj në një "zonë

vila dhe pallate. Banorë të këtij komuniteti, u mbledhën së bashku me qëllim jo vetëm argëtimin, por edhe ndarjen së bashku të problemeve të tyre. "Ne konsistojmë në këhimin e saj në një "zonë model" në aspektin mjedisor dhe social", u shprehën përfaqësuesit e bashkisë. Sipas tyre, është zgjedhur pikërisht kjo zonë e komunitetit për vetë faktin se prej më se një viti këtu po zbatohet një projekt për selektimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane, si dhe është një zonë e rikonstruktuar rishtazi. Synimi i Bashkisë së Tiranës në organizimin e këtij aktiviteti ka qenë edhe fakti që nëpërmjet këtyre ditëve të rëndësishme ajo mundohet të tërheqë vëmendjen e mbarë komunitetit për të marrë masa mbrojtëse dhe rigjeneruese për mjedisin, si një balancë natyrore që krijohet për mirëqenien e njerëzimit. Gjithashtu, tentohet edhe tërheqja e vëmendjes së institucioneve shtetërore, forcimi i lidhjeve publik-privat-shoqëri civile, mbi problemet mjedisore dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet iniciativave të përbashkëta. Aty u bë edhe vendosja e tabelave të tipit vlerësues dhe udhëzues nëpër pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, të cilat do të orientojnë komunitetin për një trajtim sa më të mirë të mjedisit. Ideja e Ditës së Fqinjësisë së Mirë lindi në vitin 1990, kur Atanase Périfan dhe miqtë e tij krijuan shoqatën "Parisi i miqve - shtëpi për miqësi" për të nxitur lidhjet në vazhdimësi ndërmjet njerëzve dhe për t'i mobilizuar ata të veprojnë kundër izolimit. Kjo ditë do të shërbejë dhe për krijimin e një ndjenje dhe kulture bashkëjetese, respekti dhe miqësie të komunitetit me njëri-tjetrin. A. Rr.